



# **PROTOKOLL**

PËR AVANCIMIN E BASHKËPUNIMIT  
TË MEKANIZMAVE LOKAL PËR MBROJTJE  
NGA DISKRIMINIMI NË KOMUNËN E KUMANOVËS

PROTOKOLL PËR AVANCIMIN E BASHKËPUNIMIT  
TË MEKANIZMAVE LOKAL PËR MBROJTJE NGA  
DISKRIMINIMI NË KOMUNËN E KUMANOVËS

PËRMBAJTJA

1. Hyrje .....	4
2. Institucionet e inkuadruara në zbatimin e protokollit dhe mënyra e realizimit të aktiviteteve për përmirësimin e mbrojtjes nga diskriminimi në Komunën e Kumanovës .....	6
2.1. Koordinatori për mundësi të barabarta të femrës dhe mashkullit .....	7
2.2. Komisioni për mundësi të barabarta të femrës dhe mashkullit .....	8
2.3. Zyra rajonale e Avokatit të Popullit .....	9
2.4. Zyra rajonale e Ministrisë së Drejtësisë .....	10
2.5. Organizata qytetare të cilat punojnë në çështjet e të drejtave të njeriut dhe mbrojtja nga diskriminimi të bashkësive të marginalizuara .....	11
3. Trupi koordinues lokal për mbrojtje nga diskriminimi .....	14
4. Roli i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi në nivel lokal ...	18
ANEKSI 1: Procedura para Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi .....	20
ANEKSI 2: Definicione dhe terme të cilat mund të përdoren në procedurat në raste të mbrojtjes nga diskriminimi mbi baza të gjinisë, orientimit seksual dhe identitetit gjinor .....	22
ANEKSI 3: Praktika juridike për mbrojtje nga diskriminimi mbi baza të gjinisë, orientimit seksual dhe identitetit gjinor .....	28
ANEKSI 4: Kontakte të organizatave qytetare të cilat punojnë në mbrojtjen nga diskriminimi dhe ndihma juridike pa pagesë .....	36
ANEKSI 5: Kontakte të institucioneve të cilat punojnë në mbrojtjen nga diskriminimi dhe ndihma juridike pa pagesë në Komunën e Kumanovës .....	40
ANEKSI 6: Formularët për dorëzimin e parashtesave deri te Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi dhe Avokati i Popullit ....	42

# 1. Hyrje

1. Diskriminimi është dukuri e cila paraqitet në kuadër të çdo bashkësie lokale, mbi baza të ndryshme, përmes formave të ndryshme dhe në fusha të cilat janë në kompetencë të pushtetit qendror dhe lokal.
2. Barazia, është një nga parimet themelore kushtetuese dhe është e garantuar me Kushtetutë, ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare. Të gjitha institucionet kanë për obligim që t'i respektojnë këto akte dhe të punojnë në avancimin e parimit të barazisë dhe jo diskriminimit, pavarësisht nëse kjo është puna e tyre parësore ose është parim të cilin duhet ta respektojnë në realizimin e kompetencave të tyre me karakter publik.
3. Duke pasur parasysh se Avokati Popullit ka zyra të veta në gjashtë rajone, ndërsa Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi është i centralizuar në Qytetin e Shkupit, forcohet nevoja nga aktiviteti më i madh i komunave, përmes koordinatoreve të tyre për mundësi të barabarta, në procesin e parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi të banorëve të komunave.
4. Qëllimi i këtij protokoll është ta avancojë parashtrimin e parashtresave nga ana e viktimave të diskriminimit në nivel lokal, ta përshkruajë rolin e koordinatoreve për mundësi të barabarta dhe bashkëpunimi me njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë në Komunën e Kumanovës në procesin e dhënies së ndihmës juridike pa pagesë dhe ndërmjetësimi me Avokatin e Popullit dhe Komisionin për mbrojtje nga diskriminimi, duke përfshirë edhe kompetencat dhe procedurën e brendshme të këtyre institucioneve përgjegjëse për mbrojtje nga diskriminimi.
5. Me qëllim të parashtrimit të parashtresave për mbrojtje nga diskriminimi të mbështetura me fakte dhe dëshmi adekuate dhe me elemente qartë të caktuara të diskriminimit, e domosdoshme është qasja deri te ndihma juridike për viktimat. Duke marrë parasysh përqindjen e lartë të qytetarëve të cilët janë në gjendje të vështirë materiale, ndërsa njëkohësisht janë viktimat të ndonjë forme të diskriminimit mbi baza të ndryshme, e domosdoshme është përfshirja e njësisë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë, e cila jep ndihmë juridike pa pagesë në procedurën e mbrojtjes nga diskriminimi.
6. Protokoll është bazuar mbi vendosjen ligjore të institucioneve, kompetencat e tyre, procedurat e brendshme dhe lidhjet mes tyre, duke pasur parasysh se mbrojtja efiçente nga diskriminimi është e mundur vetëm nëse flitet për sistem për mbrojtje nga diskriminimi, e jo vetëm për institucione të caktuara.

**2. Institucionet e inkuadruara  
në zbatimin e protokollit  
dhe mënyra e realizimit të  
aktiviteteve për përmirësimin  
e mbrojtjes nga diskriminimi  
në Komunën e Kumanovës**

## 2.1. Koordinator për mundësi të barabarta të femrës dhe mashkullit

7. Komuna e Kumanovës është e obliguar që ta respektojë parimin e mundësive të barabarta dhe mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe t'i promovojë mundësitë e barabarta të femrës dhe mashkullit në nivel lokal.
8. Komuna e Kumanovës nga radhët e nëpunësve shtetëror cakton Koordinator për mundësi të barabarta të femrës dhe mashkullit (Koordinator) i/e cili/a i avancon mundësitë e barabarta dhe jo diskriminimin në suaza të kompetencave të njësisë së vetëqeverisjes lokale përmes dorëzimit të propozimeve dhe mendimeve deri te këshilli i Komunës së Kumanovës dhe deri te institucionet dhe organizatat të cilat punojnë në nivel lokal.
9. Koordinatori ndërmerr veprime për mbrojtje nga diskriminimi mbi baza të gjinisë.
10. Diskriminimi mbi baza të gjinisë është çdo dallim, përjashtim ose kufizim mbi baza të gjinisë, që ka për pasojë ose për qëllim ta rrezikojë ose mos ta mundësojë njohjen, realizimin ose praktikimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore mbi baza të barazisë së femrës dhe mashkullit në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe qytetare, pa marrë parasysh racën e tyre, ngjyrën e lëkurës, gjininë, përkatësinë në grup të marginalizuar, përkatësinë etnike, gjuhën, shtetësinë, prejardhjen sociale, religjionin ose bindjen fetare, arsimin, përkatësinë politike, statusin personal ose shoqëror, kufizimet mentale dhe trupore, moshën, statusin familjar ose martesor, statusin pronësor, gjendjen shëndetësore ose mbi cilëndo bazë tjetër.
11. Koordinatori vepron dhe ndërmerr veprime për mbrojtje nga diskriminimi mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si pjesë nga lista e hapur e bazave të përmendura në Ligjin për mundësi të barabarta të femrës dhe mashkullit (LMBFM) "ose cilëndo bazë tjetër".
12. Koordinatori kujdeset për përfshirjen e perspektivës gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi në të gjitha aktet dhe politikat të cilat i miraton Komuna e Kumanovës.



13. Koordinator i informon qytetarët për të gjitha kompetencat e tija ligjore, që ta vëzhgojë dhe ta avancojë gjendjen me mbrojtjen nga diskriminimi, përmes shtypit dhe distribuimit të fletëpalosjeve, posterëve dhe materialit tjetër të shtypur; përmes pjesëmarrjes në mediat lokale dhe takime të drejtpërdrejta me qytetarët.
14. Koordinator organizon trajnime të vazhdueshme për të punësuarit në Komunën e Kumanovës për mbrojtje nga diskriminimi, duke përfshirë edhe diskriminimin mbi baza të gjinisë, identitetit gjinor dhe orientimit seksual.
15. Koordinator organizon fushata për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve në Komunën e Kumanovës për barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi mbi të gjitha bazat, duke përfshirë edhe mbi baza të gjinisë, orientimit seksual dhe identitetin gjinor.
16. Koordinator inicicion formimin e trupit koordinues për mbrojtje nga diskriminimi në nivel lokal, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve dhe organizatave qytetare që punojnë në Komunën e Kumanovës.
17. Për aktivitetet e trupit koordinues, Koordinatori raporton në raportet e veta vjetore, të cilat janë publike në internet faqen e Komunës së Kumanovës.

## 2.2. Komisioni për mundësi të barabarta të femrës dhe mashkullit (KEM)

18. Komuna e Kumanovës formon Komision për mundësi të barabarta të mashkullit dhe femrës (KMB), si trup i përhershëm me vendim të Këshillit të Komunës së Kumanovës. Përbërja, kompetencat dhe detyrat caktohen me Statutin e Komunës së Kumanovës.
19. KMB jep mendim lidhur me materialet dhe propozimet për mbledhjet e Këshillit të Komunës së Kumanovës nga aspekti i implementimit të parimit të mundësive të barabarta dhe jo diskriminimit dhe merr pjesë në krijimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike të komunës.
20. KMB identifikon dhe jep propozime për mënyrat e inkorporimit dhe formalizimit të parimit të mundësive të barabarta dhe jo

diskriminimit në punën e organeve të Komunës së Kumanovës dhe administratës komunale dhe kujdeset për zbatimin konsekuent të Ligjit për mundësi të barabarta dhe rregullat nga fusha e mundësive të barabarta dhe jo diskriminimit. KMB i propozon masa dhe aktivitete Këshillit të Komunës së Kumanovës në drejtim të avancimit të mundësive të barabarta dhe jo diskriminimit, duke përfshirë edhe diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetin gjinor.

21. KMB bashkë me Koordinatorin dhe në bashkëpunim me institucionet tjera lokale dhe organizatat qytetare përpilon dokumente strategjike për avancimin e mundësive të barabarta, barazisë gjinore dhe jo diskriminimin, që miratohen nga Këshilli i Komunës së Kumanovës.
22. KMB bashkëpunon me Koordinatorin, zyrën rajonale të Avokatit të Popullit, njësinë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë, organizatat qytetare dhe institucionet tjera lokale me qëllim të krijimit të përbashkët të masave dhe aktiviteteve për avancimin e mundësive të barabarta dhe jo diskriminimin.

### 2.3. Zyra rajonale e Avokatit të Popullit

23. Avokati i Popullit në kryerjen e punëve që janë në kompetencë të tij ndërmer masa dhe veprime për të cilat është i autorizuar për shkak të mbrojtjes dhe promovimit të drejtave kushtetuese dhe ligjore ose mbrojtjen e parimeve të jo diskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të qytetarëve, të cilët i takojnë të gjitha bashkësive të cilat janë shkelur nga ana e organeve (organet e aparatit shtetëror dhe organet dhe organizatat të cilat kryejnë punë publike).
24. Qytetarët kur bëhen viktimat të diskriminimit nga ana e organeve të aparatit shtetëror (siç janë ministritë, agjencitë, byrotë, fondet etj.) dhe nga ana e organeve dhe organizatave tjera të cilat kanë autorizime publike (institucionet arsimore, institucionet shëndetësore, ndërmarrjet publike, komunat etj.) mund të parashtrajnë parashtesa deri te Avokati i Popullit.
25. Avokati i Popullit me qëllim të promovimit të drejtave dhe lirive të njeriut e vëzhgon gjendjen e respektimit të drejtave të njeriut dhe tregon për nevojën nga mbrojtja e tyre, bën hetime, organizon

aktivitete edukative, e informon opinionin, bashkëpunon me sektorin civil dhe opinionin akademik.

26. Zyra rajonale e Avokatit të Popullit në Komunën e Kumanovës pranon palë, i dëgjon dhe nëse ekziston bazë për nisjen e procedurës për mbrojtje nga diskriminimi, formon lëndë e cila dërgohet deri te departamenti për mbrojtje nga diskriminimi në Shkup.
27. Nëse bëhet fjalë për diskriminim nga ana e personit të tretë, që nuk është në kompetencë të Avokatit të Popullit, zyra rajonale e këshillon dhe e dërgon palën deri te mekanizmat tjerë për mbrojtje nga diskriminimi. (Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, gjykata kompetente).
28. Zyra rajonale i informon palët edhe për ndihmën ekzistuese pa pagesë në Ministrinë e Drejtësisë dhe te organizatat qytetare të cilat punojnë në territorin e Komunës së Kumanovës.
29. Zyra rajonale i dokumenton rastet e diskriminimit të paraqitura në këtë institucion dhe për të njëjtat informon në raportet vjetore të Avokatit të Popullit.

## 2.4. Zyra rajonale e Ministrisë së Drejtësisë

30. Viktimat e diskriminimit të cilat financiarisht nuk janë të siguruara kanë të drejtë për ndihmë juridike pa pagesë, e cila mund të merret në njësinë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë në Kumanovë.
31. Procedura për realizimin e të drejtës së ndihmës juridike pa pagesë është caktuar me Ligjin për ndihmë juridike pa pagesë, ku janë caktuar llojet e ndihmës juridike dhe kriteret të cilat qytetarët duhet t'i plotësojnë që të fitojnë ndihmë juridike pa pagesë.
32. Zyra rajonale e Ministrisë së Drejtësisë në Komunën e Kumanovës u jep njerëzve ndihmë paraprake juridike të cilët janë viktimat të diskriminimit në fushën e sigurimit social, shëndetësor, pensional ose invalidor, marrëdhënieve të punës, mbrojtjes së fëmijëve, mbrojtjes së viktimave të dhunës familjare, mbrojtja e viktimave të veprave penale, mbrojtja e viktimave nga tregtia me njerëz, në procedurën për njohjen e të drejtës për azil dhe çështjet pronësore-juridike.

33. Nëse viktimat kanë nevojë dhe i plotësojnë kushtet, Ministria e Drejtësisë do t'u miratojë avokat pa pagesë, i cili do t'i përfaqësojë para institucioneve dhe gjykatave kompetente.
34. Njësia rajonale e Ministrisë së Drejtësisë i informon viktimat e diskriminimit, pavarësisht nëse i plotëson kushtet për ndihmën juridike pa pagesë, për mekanizmat ekzistuese për mbrojtje nga diskriminimi dhe mënyrën në të cilën mund ta realizojnë mbrojtjen e vet.
35. Njësia rajonale e Ministrisë së Drejtësisë i informon dhe i udhëzon viktimat e diskriminimit, deri te organizatat qytetare që realizojnë aktivitete në Komunën e Kumanovës, ndërsa të cilat punojnë me gratë, LGBTI njerëzit dhe bashkësitë tjera të marginalizuara, me qëllim të sigurimit të mbështetjes gjithëpërfshirëse të viktimave të diskriminimit.

## 2.5. Organizatat qytetare të cilat punojnë në çështjet e të drejtave të njeriut dhe mbrojtja nga diskriminimi të bashkësive të marginalizuara

36. Organizatat qytetare të cilat realizojnë aktivitete në territorin e Komunës së Kumanovës, në mënyrë aktive do të inkuadrohen në avancimin e mundësive të barabarta dhe mbrojtjen nga diskriminimi në nivel lokal.
37. Organizatat qytetare i informon grupet e veta qëllimore për mekanizmat ekzistuese për mbrojtje nga diskriminimi në nivel lokal dhe qendror, dhe sipas nevojës i udhëzon para të njëjtave të nisin procedurë dhe kërkojnë mbrojtje.
38. Organizatat qytetare të cilat janë të regjistruara për ofrimin e ndihmës juridike pa pagesë sigurojnë ndihmë juridike pa pagesë për viktimat, të cilat i plotësojnë kushtet në pajtim me Ligjin për ndihmë juridike pa pagesë, ndërsa të tjerët i informojnë dhe i udhëzojnë deri te organizatat tjera qytetare, të cilat ofrojnë ndihmë juridike pa pagesë ose deri te institucionet të cilat ofrojnë mbrojtje nga diskriminimi.
39. Organizatat qytetare organizojnë trajnime për grupet e tyre qëllimore, me qëllim që t'i informojnë për të drejtat e tyre dhe mënyrën se si ta realizojnë mbrojtjen nga diskriminimi.

40. Organizatat qytetare, njohuritë e veta profesionale si dhe përvojën e tyre, fushën në të cilën punojnë e vënë në dispozicion të institucioneve, të cilat punojnë në nivel lokal, me qëllim që t'i avancojnë mundësitë e barabarta dhe ta përmirësojnë mbrojtjen nga diskriminimi në Komunën e Kumanovës.
41. Organizatat qytetare marrin pjesë në mbledhjet koordinatave, gjatë të cilave i ndajnë njohuritë, analizat e tyre dhe rastet e diskriminimit dhe propozojnë ndërmarrjen e aktiviteteve konkrete për zgjidhjen e rasteve të diskriminimit.



# **3. Trupi lokal koordinues për mbrojtje nga diskriminimi në Komunën e Kumanovës**

42. Me këtë protokoll formohet trupi koordinues për mbrojtje nga diskriminimi në Komunën e Kumanovës.
43. Trupi koordinues është i përbërë nga Koordinatori për mundësi të barabarta, kryetari i Komisionit për mundësi të barabarta, zëvendës Avokati i Popullit nga zyra rajonale e Avokatit të Popullit në Komunën e Kumanovës, përfaqësuesi i zyrës rajonale të Ministrisë së Drejtësisë në Komunën e Kumanovës, i/e cili/a punon në ofrimin e ndihmës juridike pa pagesë, përfaqësues të organizatave qytetare të cilët janë të autorizuar të japin ndihmë juridike pa pagesë dhe organizatat tjera të cilat punojnë në mbrojtjen nga diskriminimi, duke përfshirë edhe mbrojtjen nga diskriminimi mbi baza të orientimit seksual dhe identitetet gjinor.
44. Me qëllim të përmirësimit të mbrojtjes nga diskriminimi në Komunën e Kumanovës, Koordinatori për mundësi të barabarta është pika e kontaktit për mbrojtje nga diskriminimi në nivel lokal dhe në bashkëpunim me mekanizmat tjerë për mbrojtje nga diskriminimi do të punojë në avancimin e mundësive të barabarta dhe jo diskriminimin.
45. Koordinatori me iniciativën e tij ose me propozim të institucioneve dhe organizatave tjera, do të ftojë edhe përfaqësues të institucioneve tjera të cilët punojnë në nivel lokal, të marrin pjesë në mbledhjet koordinuese, të cilët në pajtim me kompetencat e tyre mund të kontribuojnë për përmirësimin e gjendjes me mbrojtjen nga diskriminimi në Komunën e Kumanovës.
46. Për vëzhgimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e gjendjes me mbrojtjen nga diskriminimi, Koordinatori organizon së paku dy mbledhje në vjet.
47. Përfaqësuesi i njësisë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë në Komunën e Kumanovës, rregullisht dhe në mënyrë aktive merr pjesë në mbledhjet koordinuese ku raporton për rastet e diskriminimit, të cilët kanë kërkuar ndihmë juridike pa pagesë, formën e diskriminimit, bazën për mbrojtje nga diskriminimi, fusha në të cilën është kryer diskriminimi dhe numri i kërkesave të miratuara për ndihmë juridike pa pagesë për mbrojtje nga diskriminimi.



48. Përfaqësuesi i njësisë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë informon edhe për trendin e rritjes ose zvogëlimit të formave të caktuara të diskriminimit, për të cilat qytetarët kanë kërkuar ndihmë juridike pa pagesë.
49. Zyra rajonale e Avokatit të Popullit në Komunën e Kumanovës në bashkëpunim me Koordinatorin për mundësi të barabarta dhe institucionet dhe organizatat tjera, në mënyrë aktive merr pjesë në aktivitete për promovimin e konceptit të jo diskriminimit në nivel të komunës dhe rajonin që e mbulon.
50. Zëvendës Avokati i Popullit në mënyrë aktive merr pjesë në mbledhjen koordinuese me mekanizmat tjerë për mbrojtje nga diskriminimi, ku i ndan informatat për numrin e rasteve të paraqitura të diskriminimit, bazën mbi të cilat është kryer diskriminimi dhe rritja/zvogëlimi i diskriminimit në fusha të caktuara ose nga ana e kryesve potencial të diskriminimit.
51. Koordinatorin me iniciativë të tij ose me propozim të institucioneve dhe organizatave tjera, mund të thirrë edhe përfaqësues të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi që të marrë pjesë në mbledhjet koordinuese.
52. Trupi koordinues propozon aktivitete për avancimin e mundësive të barabarta dhe mbrojtjen nga diskriminimi në nivel lokal, të cilat do të realizohen në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat tjera të cilat punojnë në Komunën e Kumanovës.
53. Trupi koordinues organizon evenimente për promovimin dhe informimin e punës së vet në opinion, organizon fushata për ngritjen e vetëdijes së popullatës për llojet dhe format e diskriminimit dhe mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi, si dhe ndërmerr aktivitete tjera në drejtim të avancimit të gjendjes me mundësitë e barabarta dhe mbrojtja nga diskriminimi në Komunën e Kumanovës.



# **4. Roli i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi në nivel lokal**

54. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi (në tekstin e mëtejshëm KMD) është organ i pavarur për mbrojtje nga diskriminimi me seli në Qytetin e Shkupit, në rr. Kej Dimitar Vllahov p.n., ndërtesa e RTVM, kati 20.
55. KMD vepron sipas parashtesave dhe jep mendim dhe rekomandime për raste konkrete të diskriminimit, duke përfshirë edhe rastet e diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
56. KMD me kërkesë të Këshillit të Komunës së Kumanovës, mund të japë mendim rreth vendimeve të këshillit, nga aspekti i rrëfimit të ekzistimit të normave diskriminuese.
57. Me iniciativën e tij ose me iniciativë të palëve të treta, KMD bënë analiza të akteve të miratuara të komunës nga aspekti i diskriminimit dhe tregon për normat e mundshme diskriminuese.
58. KMD jep mendim për aktivitetet të cilat i ndërmerr kryetari i komunës, këshilli si dhe ndërmarrjet publike të formuara nga ana e komunës nga aspekti i ekzistimit të veprimeve diskriminuese në pajtim me Ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.
59. KMD bashkë me Komunën e Kumanovës mund të organizojë evenimente promovuese, punëtori dhje këshillime. Komuna, në ueb faqen e vet, i vendos linqet të cilat lidhen me ueb faqen e KMD dhe deri te formulari për parashtrimin e parashtesave, si dhe informata për aktivitete përt avancimin e barazisë në nivel lokal.
60. KMD bashkë me komunën dhe/ose me institucione dhe shoqata tjera mund ta vëzhgojnë gjendjen me diskriminimin në nivel lokal, përmes hulumtimit të dukurive të caktuara të diskriminimit.
61. Komuna e Kumanovës deri te KMD dorëzon të dhëna statistikore dhe të dhëna tjera të nevojshme për vërtetimin e gjendjes me diskriminimin në nivel lokal.



## Procedura para Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi

Viktimat e diskriminimit mund të parashtrojnë parashtesë në formë, e cila është e caktuar nga ana e KMD. KMD i pranon dhe shqyrton parashtesat të cilat nuk janë dorëzuar në formën e duhur. Formulari gjendet në Aneksin e këtij protokolli, ndërsa i njëjti përmban edhe orientimin seksual si bazë për mbrojtje nga diskriminimi.

Parashtesa mund të parashtrohet personalisht ose gojarisht në zyrat e KMD, me telefon gjatë orarit të punës së KMD, çdo ditë pune prej të hënës deri te premten nga ora 9-16. KMD ka postë elektronike zyrtare përmes së cilës i pranon parashtesat për mbrojtje nga diskriminimi (contact@kzd.mk)

Parashtesa mund të dorëzohet edhe on-line, gjegjësisht në ueb faqen e KMD (www.kzd.mk) ka aplikacion i cili plotësohet dhe menjëherë dorëzohet në mënyrë elektronike, pa u përdorur posta elektronike.

KMD mund t'i thirrë palët në zyrat e veta për shkak të grumbullimit të informatave shtesë dhe sqarim për fakte të caktuara që kanë rëndësi në procedurën.

KMD mund të dale në vendin e ngjarjes dhe përmes dokumenteve dhe informatave të kapshme të diskriminuesi potencial të grumbullojë dëshmi të nevojshme për vërtetimin e drejt të gjendjes faktike.

Nëse vërtetohet ekzistimi i diskriminimit, KMD përgatit mendim me shkrim, në të cilin gjendet vërejtja deri te diskriminuesi se ka për obligim në afat prej 30 ditëve ta mënjojë diskriminimin.

# ANEKSI 2

## Definicione dhe terme të cilat mund të përdoren në procedurat në raste të mbrojtjes nga diskriminimi mbi baza të gjinisë, orientimit seksual dhe identitetit gjinor

**Diskriminimi** – dallim, përjashtim ose kufizim i njerëzve mbi baza të karakteristikave të tyre personale, me çka rrezikohet ose pamundësohet njohja dhe realizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Çdo veprim që shkakton trajtim jo të barabartë, që nuk është legjitime dhe e bazuar proporcionalisht, e me të cilën një individ ose grup përjashtohet ose kufizohet në gëzimin e të drejtave për shkak të karakteristikave të caktuara personale.

**Seksi** – karakteristika biologjike dhe fiziologjike sipas të cilave njerëzit ndahen në meshkuj dhe femra. Më shpesh, seksi caktohet gjatë lindjes mbi baza të kombinimit të karakteristikave trupore (gjenitaleve) si dhe organeve të brendshme riprodhuese.

**Gjinia** – paraqet role të konstruara sociale, sjelljet, vlerat, aktivitetet dhe atributet të cilat shoqëria i llogarit për adekuate për femrat dhe meshkujt. Gjinia është identitet i fituar, i cili është i mësuar, ndryshon me kohën dhe ndryshon në dhe përmes kulturave.

**Barazia gjinore** – ka të bëjë me konceptin se femrat dhe meshkujt janë të lirë që t'i zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të zgjedhin pa kufizime nga stereotipat e vendosur, paragjykimet dhe rolet e rrepta gjinore. Të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e femrave dhe meshkujve nuk do të varen nga ajo nëse kanë lindur si meshkuj ose si femra.

**Mundësi të barabarta të femrës dhe mashkullit** – mungesa e pengesave për pjesëmarrje ekonomike, politike dhe sociale mbi baza të gjinisë. Promovimi i parimit për vendosjen e pjesëmarrjes së barabartë të femrës dhe mashkullit në të gjitha fushat e sektorit publik dhe privat, status dhe trajtim i barabartë në realizimin e të gjitha të drejtave dhe



në zhvillimin e potencialeve të tyre individuale, përmes të cilave ata kontribuojnë në zhvillimin shoqëror, si dhe përfitime të barabarta nga rezultatet e dala nga ai zhvillim.

**LGBT** – Term gjithëpërfshirës i cili ka të bëjë me njerëzit të cilët identifikohen si lezbike, gej meshkujt, biseksualët dhe/ose trans.

**Orientimi seksual** – aftësia për tërheqje emocionale, romantike dhe fizike ndaj një personi të caktuar; partneri/partnerët mund të jenë të seksit të ndryshëm (heteroseksual), të seksit të njëjtë (homoseksual) ose të dy sekseve (biseksual). Orientimi seksual nuk është i ndërlidhur me identitetin gjinor. Trans njerëzit, po ashtu edhe njerëzit gjinia e të cilëve përputhet me seksin biologjik, mund të jenë heteroseksual, homoseksual, biseksual, aseksual etj.

**Biseksualiteti** – orientim seksual i cili ka të bëjë me njerëzit të cilët tërhiqen seksualisht, emocionalisht dhe fizikisht nga të dy sekset, njerëzit quhen biseksual.

**Heteroseksualiteti** – orientim seksual i cili ka të bëjë me ata të cilët tërhiqen seksualisht, emocionalisht ose fizikisht nga persona të seksit të ndryshëm.

**Homoseksualiteti** – orientim seksual i cili ka të bëjë me ata njerëz tërheqja seksuale, emocionale, fizike e të cilëve kryesisht është orientuar drejt personave të seksit të njëjtë. Zakonisht, meshkujt që tërhiqen nga meshkujt tjerë quhen gej, ndërsa femrat e tërhequra nga femrat tjera quhen lezbike (edhe pse të njëjtit mund të përcaktohen / identifikohen si gej).

**MSM** - ('meshkuj që kanë seks me meshkuj' ose 'seks mes meshkujve') është term i cili përdoret në shëndetësinë publike dhe ka të bëjë me cilindo mashkull i cili ka marrëdhënie seksuale me mashkull tjetër pa dallim nëse kjo ndodh përkohësisht, rregullisht ose si shprehje e identitetit homoseksual. Termi përdoret që të përshkruhet tip i

aktivitetit seksual pa hyrë në përcaktimin e identitetit të personave (orientim homoseksual dhe heteroseksual) dhe përdoret me qëllim të intervenimeve shëndetësore (veçanërisht parandalim dhe trajtim të HIV/SIDA, arsimit dhe shërbimet) që të mund t'u ofrohen personave mbi bazë të nevojës së tyre. Termi ekuivalent FSM (grua me grua) nuk ekziston në dokumentet publike, por përdoret në hulumtime.

**Identiteti gjinor** – ndjenjë e brendshme thellë e rrënjosur për përkatësinë gjinore të individit, identifikim personal i një personi lidhur me veten, një spektër i tërë i faktorëve. Te shumica e njerëzve, identiteti gjinor është në pajtim me seksin e caktuar, derisa te trans njerëzit identiteti gjinor nuk është në pajtim me seksin e caktuar gjatë lindjes. Këtu merr pjesë edhe përvoja personale për trupin (që mund të nënkuptojë ndryshim i pamjes fizike ose funksioneve trupore me ndihmë të mjeteve mjekësore, kirurgjike e tjera, nëse ky ndryshim është me zgjedhje të lirë) si dhe shprehje tjera të gjinisë si rrobat, të folurit dhe vijat e karakterit.

**(Trans) Njerëzit transgjinor** – Term gjithëpërfshirës që e përdorin shumë njerëz të cilët nuk identifikohen me gjininë e tyre të caktuar. Termi i përfshinë transseksualët, njerëzit transgjinor, interseksualët dhe njerëz me dallime/variante tjera gjinore, por nuk kufizohet vetëm me ata.

**Transseksualët** – njerëz të cilët kanë kaluar ose kanë për qëllim të kalojnë nëpër procedura tranzitore mjekësore, si për shembull terapia hormonale, intervenime kirurgjike dhe ndryshim i dokumenteve për identifikim personal, me qëllim që ta vërtetojnë identitetin e tyre gjinor. Trans femrat, të cilat biologjikisht kanë lindur si pjesëtare të seksit mashkullor, ndërsa janë me identitet gjinor të femrës, quhen mashkull drejt femrës (MTF-male-to-female). Trans meshkuj seksi biologjik i të cilëve është fituar me lindjen janë femra, ndërsa me identitet gjinor të mashkullit, quhen femra drejt mashkullit (FTM – female-to-male). Njerëzit transgjinor dhe transseksual mund të identifikohen si heteroseksual, homoseksual (gej, lezbike), biseksual ose me orientim tjetër seksual. Me fjalë të tjera, identiteti gjinor dhe orientimi seksual nuk varen njëra nga tjetra.

**Interseksualët** – njerëz të cilët kanë lindur me gjenitale dhe organe riprodhuese të cilat nuk mund të definojnë si tipike mashkullore, e as si tipike femërore. Pjesa më e madhe e personaliteteve interseksuale janë viktimat të intervenimeve të panevojshme kirurgjike dhe terapive hormonale, shpesh të kryera pa pëlqimin e tyre. Në të kaluarën për interseksualët është përdorur termi hermafrodit, i cili përdoret edhe sot, por llogaritet si joadekuat dhe ofendues. Shumë interseksualë e mendojnë veten si pjesë e trans bashkësisë.

**Homofobia** – frikë, urrejtje, paragjykim dhe diskriminim i konstruktuar irracional ose shoqëror ndaj njerëzve me orientim homoseksual dhe biseksual dhe të gjithë ata për të cilët në përgjithësi supozohet se janë meshkuj gej, lezbike ose biseksual.

**Transfobia** – Ndjenjë e fuqishme e refuzimit, mospranimi, paragjykim dhe urrejtje ndaj trans njerëzve, për shkak të identitetit ose shprehjes të tyre të vërtetë ose të supozuar gjinore.

**Person cisgjnor** – identiteti gjinor i të cilëve është në pajtim me seksin e tij/saj biologjik.



# ANEKSI 3

# Praktika juridike për mbrojtje nga diskriminimi mbi baza të gjinisë, orientimit seksual dhe identitetit gjinor

## 1. Praktika juridike ndërkombëtare për mbrojtje nga diskriminimi mbi baza të seksit/gjinisë

### 1.1. Komiteti për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit mbi femrat

#### **A.T. v. Hungary**

Komiteti mendon se mbrojtja joadekuate e viktimës së dhunës familjare paraqet shkelje të obligimit të shtetit të sigurojë mbrojtje nga diskriminimi mbi femrat dhe të sigurojë barazi gjinore. Mungesa e legjislacionit specifik me të cilën do të pengohet dhuna familjare, i ruan paragjykimet dhe zakonet e bazuara në fakte se femrat janë inferiore, me çka kryhet edhe diskriminim në fushën e martesës dhe familjes.

#### **A.S. v. Hungary**

Komiteti ka vërtetuar diskriminim në realizimin e mbrojtjes shëndetësore dhe planifikimin e familjes së femrës rome, e cila ka qenë e sterilizuar pa pajtimin e saj. Komiteti mendon se shteti i ka shkelur të drejtën e gruas kur punëtorët shëndetësorë të cilët e kanë lindur, e kanë sterilizuar me çka përgjithmonë ia kanë kufizuar të drejtën të ketë fëmijë të tjerë, pa marrë pëlqim nga ajo.

#### **Vertido v. Philippines**

Komiteti ka vërtetuar se gjykata në shqyrtimin e rastit të gruas së përdhunuar, në mënyrë jo adekuate janë mbështetur në stereotipat e bazuar në gjini lidhur me veprën penale të përdhunimit dhe viktimat dhe nuk ka vërtetuar përgjegjësi të sulmuesi, me çka ka kryer diskriminim të viktimës së përdhunimit. Sipas Komitetit, gjykata ka për obligim të sigurojë mjet efikas juridik për viktimën që nënkupton rigjykim fer, të pavarur dhe me kohë në rast të përdhunimit të dhunës seksuale.

## **Da Silva Pimental v. Brazil**

Komiteti ka vërtetuar diskriminim në qasjen deri te shërbimet shëndetësore në institucionin privat shëndetësor në rastin kur viktimja ka pasur abort spontan, ndërsa nuk ka marrë kujdes mjekësor në kohë, për shkak të cilës ka vdekur. Komiteti mendon se viktimja është përgjegjëse për veprimin e institucioneve shëndetësore private. Mungesa e kujdesit shëndetësor adekuat gjatë shtatzënisë, lindjes dhe mëmësisë paraqet diskriminim mbi gratë dhe ndikon negativisht mbi jetën e femrës.

## **1.2.Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut**

### **Opuz v. Turkey**

GJEDNJ mendon se ekziston shkelje e të drejtës së jetës në rastin e vrasjes së nënës së viktimës së dhunës familjare dhe veprimin johuman dhe degradues për shkak të lëshimeve të shtetit që ta mbrojnë viktimën e dhunës familjare. Gjykata ka vërtetuar se me lëshimin që të ndër marrë veprime adekuate, që ta mbrojnë viktimën dhe të parandalojë shkeljen e të drejtës së jetës, shteti ka kryer diskriminim. Dhuna nëpër të cilën ka kaluar viktimja dhe nëna e saj bazuar në gjini dhe i diskriminon gratë.

Raste tjera në të cilat GJEDNJ ka vërtetuar diskriminim në raste të dhunës familjare: *Eremia and others v. Moldova*, *M.G. v. Turkey* e të tjera.

### **Unal Tekeli v. Turkey**

Gjykata ka vërtetuar diskriminim mbi baza të gjinisë në rast kur femra e cila gjatë lidhjes së martesës e ka marrë mbiemrin e burrit, në punë ka qenë e penguar ta përdorë edhe mbiemrin e saj të vajzërisë. Gjykata mendon se nuk është argument i mjaftueshëm se marrja e mbiemrit të burrit si rezultat i traditës është reflektim i unitetit familjar dhe të dy bashkëshortët duhet ta përdorin mbiemrin e njëjtë. Obligimi i imponuar që gratë të cilët hynë në martesë, në interes të unitetit familjar, ta mbajnë mbiemrin e burrit, bile edhe kur mund ta përdorin

edhe mbiemrin e tyre të vazhdisë para mbiemrit të burrit, nuk ka arsyetim objektiv dhe të shëndoshë dhe paraqet diskriminim.

### **Emel Boyraz v. Turkey**

Gjykata ka vërtetuar diskriminim mbi baza të gjinisë në rastin kur gruaja ka qenë e pushuar nga puna në shërbim publik. Viktima e diskriminimit tre vjet ka punuar si sigurim, por ka qenë e pushuar nga puna për shkak se, sipas punëdhënësit nuk ka qenë mashkull dhe nuk e ka kryer shërbimin ushtarak.

## **2. Praktika juridike ndërkombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor**

### **2.1. Komiteti për të drejtat e njeriut pranë Kombeve të Bashkuara**

#### **Toonen vs. Australia**

Komiteti për të drejtat e njeriut ka vendosur se ligji i Tasmanisë (Australi) me të cilin kriminalizohet lidhja vullnetare seksuale mes meshkujve të moshës madhore, e kanë shkelur të drejtën e privatësisë të garantuar me Paktin për të drejta qytetare dhe politike dhe paraqet diskriminim mbi baza të orientimit seksual.

#### **Young v. Australia (2000)**

#### **X v. Columbia (2007)**

Komiteti në të dy rastet ka vendosur se kufizimi i të drejtës së shfrytëzimit të pensionit nga partneri i vdekuri i seksit të njëjtë, e drejtë që në këtë rast ka qenë e garantuar vetëm për partnerët jashtë martesës së seksit të ndryshëm, paraqet diskriminim mbi baza të orientimit seksual. Në rastin e parë orientimin seksual Komiteti e komenton se është pjesë nga baza "seks", derisa në rastin e dytë nga viti 2007 e definojnë komentimin për orientimin seksual si "status tjetër".



## **Irina Fedotova v Russia**

Komiteti për të drejtat e njeriut në vitin 2012 ka vendosur se ekzistimi i ligjit me të cilin sanksionohen njerëzit të cilët publikisht e shprehin homoseksualitetin paraqet diskriminim mbi baza të orientimit seksual.

## 2.2.Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut

**Baczowski and others v. Poland** ankesa nr. 1543/06

**Alekseyev v. Russia** Ankesat nr. 4916/07, 25924/08 dhe 14599/09

**GENDERDOC-M v. Moldova** (Ankesa nr. 9106/06)

Gjykata në të tre rastet ka përfunduar se kufizimi i realizimit të lirive të organizimit të tubimeve publike, në të cilat promovohen të drejtat e LGBTI njerëzve, paraqet diskriminim mbi baza të orientimit seksual.

## **Salgueiro Da Silva Mouta v Portugal nr. 33290/96**

Gjykata ka vërtetuar se gjykatat e vendit me vendimin, me të cilin nuk i është dhënë kujdestaria e babait për shkak të orientimit të tij homoseksual është dallim i cili nuk është i pranueshëm në pajtim me Konventën dhe paraqet shkelje të drejtës së jetës private dhe familjare lidhur me ndalesën për diskriminim nga neni 14 nga KEDNJ.

## **E.B. vs. France ankesa nr. 43546/02**

Në këtë rast gjykata ka vërtetuar se gruaja e cila është në lidhje stabile lezbike me partneren, kërkesa e të cilës për adoptimin e fëmijës i është refuzuar, paraqet diskriminim mbi baza të orientimit të saj seksual. Në të vërtetë, Gjykata vëren se gjykata administrative ka vendosur se edhe pse është përqendruar në orientimin seksual të aplikueses, nuk kaq enë bazë për miratimin e vendimit për lëndën dhe nuk është shqyrtuar nga aspekti armiqësor. Megjithatë, sipas mendimit të Gjykatës, është i rëndësishëm fakti se orientimi seksual shpesh është përmendur në arsyetimin e vendimit dhe për shkak të mënyrës ku mendime të ndara janë shprehur, zbulon se homoseksualiteti i aplikueses ka qenë faktor vendimtar.

## **Karner v Austria ankesa nr. 40016/98**

Karner kundër Austrisë, është rasti i parë lidhur me të drejtat e partnerëve të seksit të njëjtë, të cilin GJEDNJ është pajtuar ta shqyrtojë. Pas vdekjes së partnerit të seksit të njëjtë, qiradhënësi ka filluar procedurë për ndërprerjen e qirasë së partnerit të gjallë. Gjykata themelore dhe regjionale në Vjenë, termin “bashkëshorti i jetës” nga marrëveshja për qira e komenton në mënyrë që i njëjti i përfshin edhe partnerët e seksit të njëjtë, të cilët një kohë të gjatë jetojnë bashkë. Por, Gjykata supreme nuk është pajtuar me komentimin e këtillë të gjykatave më të ulëta. Prandaj, Gjykata ka vërtetuar se Shteti nuk ka ofruar shkak bindës dhe të rëndësishëm, i cili do ta arsyetojë komentimin e ngushtë të pjesës nga Marrëveshje për qira, me të cilën pengohet që partneri i mbijetuar nga çifti i seksit të njëjtë të thirret në këtë dispozitë dhe ka vërtetuar se është kryer diskriminim mbi baza të orientimit seksual.

## **Vallianatos and others v. Greece ankesat nr. 29381/09 dhe 32684/09**

Gjykata ka vërtetuar se përjashtimi i çifteve të seksit të njëjtë nga fushëveprimi i ligjit me të cilin mundësohet partneritet qytetar vetëm për partnerët e seksit të njëjtë paraqet diskriminim mbi baza të orientimit seksual.

## **Pajic v. Croatia ankesa nr. 68453/13**

Gjykata ka vërtetuar diskriminim lidhur me gëzimin e të drejtës së jetës familjare kur nënshetëses boshnjake i është refuzuar kërkesa për rregullimin e qëndrimit të përkohshëm në Republikën e Kroacisë për shkak të bashkimit me partneren e saj. Gjykata në aktgjykim thekson se personi që ankohet dhe partnerja e saj janë në lidhje stabile disavjeçare, që paraqet bashkësi e cila është e përfshirë me konceptin për mbrojtje të jetës private. Gjykata edhe një herë e ka vërtetuar se familja nuk përfshinë vetëm çifte heteroseksuale, përkundër familja përfshinë numër të madh të formave të lidhjeve pa marrë parasysh orientimin e tyre seksual.

## **X. v. Turkey ankesa nr. 24626/09**

Gjykata mendon se izolimi i të burgosurit homoseksual në qeli burgu, me arsyetimin se për shkak të masave të sigurisë për mbrojtjen e të paraburgosurit nga lëndimet trupore, është e papranueshme dhe për shkak të kësaj kaq enë viktimë e diskriminimit mbi baza të orientimit të tij seksual.

## **Identoba and others v. Georgia**

Gjykata ka vërtetuar se sulmi mbi pjesëmarrësit në marshin paqësor për të drejtat e LGBTI njerëzve nga ana e kundër demonstruesve, dhe lëshimi i autoriteteve që t'i mbrojnë nga dhuna dhe ta hulumtojnë në mënyrë efikase incidentin, paraqet diskriminim mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Me këtë aktgjykim, GJEDNJ për herë të parë ka vërtetuar se krimi nga urrejtja i kryer mbi individët mbi baza të orientimit të tyre seksual paraqet veprim johuman dhe degradues, duke marrë parasysh nenin 14 nga Konventa me të cilin ndalohet diskriminimi.





Kontakte nga organizatat qytetare të cilat punojnë në mbrojtjen nga diskriminimi dhe ndihma juridike pa pagesë

## 1. Organizata qytetare nga Komuna e Kumanovës

Organizatë që është e autorizuar të japë ndihmë juridike pa pagesë

### **Qendra Nazionale Rome (QNR) Kumanovë**

QNR Kumanovë punon në avokimin për të drejtat e popullatës rome në Maqedoni, si dhe të gjitha grupeve në bashkësinë të cilat jetojnë në rrezik social, gjegjësisht sëmundje, varfëri, ballafaqohen me diskriminim, ndarje ose janë të rrezikuara dhe jetojnë në skaj të margjinalizimit social dhe ekonomik. Krahas aktiviteteve tjera QNR Kumanovë ofron edhe ndihmë juridike pa pagesë për qytetarët e Komunës së Kumanovës, të cilët i plotësojnë kushtet për ndihmë juridike pa pagesë.

Adresa: rr. Done Bozhinov nr. 11/3, 1300 Kumanovë

Telefoni: + 389 (0)31 427 558

E-mail: [info@nationalromacentrum.org](mailto:info@nationalromacentrum.org)

Internet faqja: [www.nationalromacentrum.org](http://www.nationalromacentrum.org)

## 2. Organizata qytetare në nivel nacional

### **Koalicioni TË DREJTAT SEKSUALE DHE SHËNDETËSORE TË BASHKËSIVE TË MARGJINALIZUARA Shkup**

Koalicioni DSSHBM punon në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të LGBTI njerëzve, përmes dokumentimit të rasteve të shkeljes së të drejtave të LGBTI njerëzve, sigurimin e ndihmës juridike pa pagesë dhe këshillimit në rast të diskriminimit mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor dhe avokimi para institucioneve kompetente. Koalicioni ofron ndihmë psiko-sociale dhe mbështetje të LGBTI njerëzve.

Adresa: Bul. Kliment Ohridski nr. 66-1/3, 1000 Shkup

Telefoni: + 389 (0)23 214 269

E-mail: [dragana.coalition@gmail.com](mailto:dragana.coalition@gmail.com)

Internet faqja: [www.coalition.org.mk](http://www.coalition.org.mk)

### **LGBTI Qendra për mbështetje**

Qendra punon me LGBTI bashkësinë përmes organizimit të grupeve për vetë-ndihmë dhe organizimin e aktiviteteve sociale. Qendra ofron ndihmë juridike pa pagesë, fond intervent, monitorim, raportim dhe avokim, përmirësimi i gjendjes me LGBTI njerëzve.

Adresa: rr. Naum Naumovski Borçe nr. 83, 1000 Shkup

Telefoni: +389 (0) 23 119 073

E-mail: [info@lgbti.mk](mailto:info@lgbti.mk)

Internet faqja: [www.lgbti.mk](http://www.lgbti.mk)

## **H.E.R.A.- Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim**

HERA ofron servise për shëndet seksual dhe riprodhues të LGBTI personave (HIV testim dhe këshillim, dermato-venerolog, gjinekolog, psikolog, psikiatër dhe punëtor social) në qendrat rinore “Dëshiroj të dijë”. Organizata ofron edhe ndihmë juridike pa pagesë në rastet e shkeljes së të drejtave të LGBT bashkësisë. Në kuadër të HERA është hapur “Qendra e parë familjare”, e cila ofron mbështetje psiko-sociale dhe këshillim në rastet e dhunës familjare dhe te LGBTI personat.

Adresa: rr. Debarca 56/4, 1000 Shkup

Telefoni: +389 (0)23 290 395

E-mail: [hera@hera.org.mk](mailto:hera@hera.org.mk)

Internet faqja: [www.hera.org.mk](http://www.hera.org.mk)

## **Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi (ESE)**

ESE punon në promovimin dhe avancimin e të drejtave shëndetësore dhe të drejtat e femrës. Organizata siguron ndihmë juridike adekuate dhe me kohë për viktimat e dhunës familjare dhe ndihmë para-juridike për grupe të caktuara të rrezikuara të qytetarëve.

Adresa: rr. Maksim Gorki nr. 20-1/4, 1000 Shkup

Telefoni: + 389 (0)23 298 295

E-mail: [esem@esem.org.mk](mailto:esem@esem.org.mk)

Internet faqja: [www.esem.org.mk](http://www.esem.org.mk)



# ANEKSI 5

## Kontakte të institucioneve që punojnë në mbrojtjen nga diskriminimi dhe ndihma juridike pa pagesë në Komunën e Kumanovës

1. Koordinatori për mundësi të barabarta të femrës dhe mashkullit në Komunën e Kumanovës

Adresa: 11 Tetori p.n., 1300 Kumanovë

Telefoni: +389 (0)31 475 800 ose +389 (0)31 438 633

E-mail: [info@kumanovo.gov.mk](mailto:info@kumanovo.gov.mk)

Internet faqja: [www.kumanovo.gov.mk](http://www.kumanovo.gov.mk)

2. Zyra rajonale e Avokatit të Popullit në Komunën e Kumanovës

Adresa: rr. "Sheshi Jugosllavia e re" nr. 24, 1300 Kumanovë

Telefoni: +389 (0)31 431 488

E-mail: [contact@ombudsman.mk](mailto:contact@ombudsman.mk)

Internet faqja: [www.ombudsman.mk](http://www.ombudsman.mk)

3. Njësia rajonale e Ministrisë së Drejtësisë në Komunën e Kumanovës

Adresa: rr. 11 Tetori p.n., 1300 Kumanovë

Telefoni: +389 (0)31 415 788

Internet faqja: [www.pravda.gov.mk](http://www.pravda.gov.mk)

# ANEKSI 6

# Formularët për parashtrimin e parashtesave deri te Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi dhe deri te Avokati i Popullit



## REPUBLIKA E MAQEDONISË

### Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi

Bul. Goxce Dellçev p.n. (Ndërtesa e RTVM), kati 20, Shkup  
tel. 02/3232-242

## PARASHTESË

**E RËNDËSISHME:** Nga parashtesa që na e dërguat, një kopje do të dorëzohet deri te personi fizik/juridik, gjegjësisht organi kundër të cilit e parashtroni parashtesën.

### TË DHËNA PESORALE TË PARASHTRUESIT

1. EMRI: \_\_\_\_\_

2. MBIEMRI: \_\_\_\_\_

3. TITULLI: \_\_\_\_\_

(nëse parashtruesi është person juridik)

4. ADRESA/SELIA: \_\_\_\_\_

(nëse parashtruesi është person juridik)

5. GJINIA: \_\_\_\_\_

6. DATA E LINDJES: \_\_\_\_\_

7. TEELFONI: \_\_\_\_\_ E-MAIL: \_\_\_\_\_

8. PËRKATËSIA ETNIKE: \_\_\_\_\_

(informata nuk është e obliguar)

9. A E PARASHTRONI PARASHTESËN NË EMËR TË NDONJË PERSONI TJETËR: \_\_\_\_\_

(përgjigjuni me PO se JO)

10. NËSE PËRGJIGJA NË PYETJEN PARAPRAKE ËSHTË POHUESE, PËRMENDNI NË EMËR TË KUJT E PARASHTRONI PARASHTESËN: \_\_\_\_\_

11. A KENI PËLQIM NGA PERSONI NË EMËR TË CILIT E PARASHTRONI PARASHTESËN:

\_\_\_\_\_ (përgjigjuni me PO ose Jo; nëse PO, të njëjtën bashkëngjitni)

**TË DHËNA PËR PERSONIN FIZIK/JURIDIK, GJEGJËSISHT ORGANI KUNDËR TË CILIT E PARASHTRONI PARASHTESËN**

**1. NËSE PARASHTESA KA TË BËJË ME PERSONIN/ORGANIN JURIDIK:**

- **TITULLI:** \_\_\_\_\_
- **SELIA:** \_\_\_\_\_
- **TELFONI:** \_\_\_\_\_
- **A JENI PUNSUAR NË KËTË PERSON/ORGAN JURIDIK:** \_\_\_\_\_  
(përgjigjuni me PO ose JO)

**2. NËSE PARASHTESA KA TË BËJË ME PERSON FIZIK:**

- **EMRI DHE MBIEMRI:** \_\_\_\_\_
- **ADRESA:** \_\_\_\_\_
- **TELEFONI:** \_\_\_\_\_
- **PERSONI PËR TË CILIN THONI SE JU DISKRIMINON A E KA BËRË KËTË NË VENDIN E PUNËS/DUKE I KRYER OBLIGIMET E PUNËS:**  
\_\_\_\_\_ (përgjigjuni me PO ose JO)
- **NËSE MARRËVESHJA PARAPRAKE ËSHTË POZITIBVE, PËRMENDNI KU ËSHTË PUNËSUAR PERSONI:** \_\_\_\_\_

(titulli i ndërmarrjes/institucionit/organizatës, adresa, telefoni, pozita/vendi i punës i personit adekuat)

**E RËNDËSISHME:** Nëse ka më tepër persona fizik dhe/ose juridik, gjegjësisht organet kundër të cilëve i parashtroni parashtesat, Ju lutemi për secilin prej tyre të plotësoni parashtesë të veçantë.

## **BAZA/T PËR DISKRIMINIM**

**Rrethojeni një ose më shumë baza të diskriminimit, mbi cilën bazë mendoni se jeni diskriminuar.**

1. **Seksi**
  2. **Raca**
  3. **Ngjyra e lëkurës**
  4. **Gjinia**
  5. **Përkatësi në grup të marginalizuar**
  6. **Përkatësia etnike**
  7. **Gjuha**
  8. **Shtetësia**
  9. **Prejardhja sociale**
  10. **Religjioni ose bindjet fetare**
  11. **Lloje tjera të besimit**
  12. **Arsimi**
  13. **Përkatësia politike**
  14. **Statusi personal ose shoqëror**
  15. **Pengesa mentale dhe trupore**
  16. **Mosha**
  17. **Statusi familjar ose bashkëshortor**
  18. **Statusi pronësor**
  19. **Gjendja shëndetësore**
  20. **Orientimi seksual dhe identiteti gjinor**
  21. **Ndonjë bazë tjetër:**  
(përmendni cila)
-

## KU NDODHI NGJARJA SIPAS TË CILIT PARASHTRONI PARASHTESË

1. PUNA DHE MARRËDHËNIET E PUNËS
2. ARSIMI, SHKENCA DHE SPORTI
3. SIGURIA SOCIALE, DUKE PËRFSHIRË EDHE RAJONIN E MBROJTJES SOCIALE, SIGURIMIN PENSIONAL DHE INVALIDOR, SIGURIMI SHËNDETËSOR DHE MBROJTJA SHËNDETËSORE
4. JURISPRUDENCA DHE DREJTORIA
5. STREHIMI
6. INFORMIMI PUBLIK DHE MEDIAT
7. QASJA DERI TE TË MIRAT DHE SHËRBIMET
8. ANËTARËSIMI DHE VEPRIMI NË SINDIKATA, PARTI POLITIKE, SHOQATA TË QYTETARËVE DHE FONDACIONE OSE ORGANIZATA TJERA TË BAZUARA NË ANËTARËSI
9. KULTURË
10. FUSHAT TJERA TË CAKTUARA ME LIGJ \_\_\_\_\_ (përmendni)

**PËRSHKRIMI I NGJARJES** (përkthyeri hollësisht ngjarjen sipas të cilës ka ndodhur parashtesa, duke përfshirë kohën, vendin, personat që kanë qenë prezent dhe ngjashëm)

---

---

---

---

---

**E RËNDËSISHME:** Nëse ju nevojitet më tepër vend për të shkruar, përdorni fletë shtesë.

DËSHMI (përmendni dëshmitë të cilat i dorëzoni në shtojcë të parashtesës)

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_

1. A KENI INICIUAR PROCEDURË GJYQËSORE \_\_\_\_\_ (përgjigjuni me PO ose JO)

2. NËSE KENI INICIUAR, PARA CILËS GJYKATË DHE KUR \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

(dorëzoni edhe fotokopje të padisë)

3. A JENI DREJTUAR DERI TE NDONJË INSTITUCION TJETËR \_\_\_\_\_ (përgjigjuni me PO ose JO)

4. NËSE JENI DREJTUAR, DERI TE KUSH DHE KUR \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

(dorëzoni edhe fotokopje nga korrespondenca)

**VENDI DHE DATA**

**NËNSHKRIM**



Deri te:

AVOKATI I POPULLIT

rr. "Dimitrie Çupovski" nr. 2

1000 Shkup



Република Македонија  
**НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ**  
**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

## PARASHTESËA

1. TË DHËNA PËR PARASHTRUESIN:

EMRI DHE MBIEMRI \_\_\_\_\_ VENDBANIMI \_\_\_\_\_

ADRESA \_\_\_\_\_ TELEFONI \_\_\_\_\_

PJESËTAR I BASHKËSISË \_\_\_\_\_

2. GJINIA: M \_\_\_\_\_ F \_\_\_\_\_

3. MOSHA \_\_\_\_\_

4. PROFESIONI \_\_\_\_\_

5. SHTETËSIA \_\_\_\_\_

6. ORGANI OSE ORGANIZATA NDAJ TË CILËS DËRGOHET PARASHTESA

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

7. EMRI, MBIEMRI DHE FUNKSIONI I NËPUNËSIT ZYRTAR I CILIE KASHKELUR TË DREJTËN E PARASHTRUESIT

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

8. NË VAZHDIM PËRMENDNI TË DHËNAT PËR AKTIN (VENDIMI, PËRFUNDIM ETJ.) ME TË CILIN JU ËSHTË SHKELUR E DREJTA OSE PËRSHKRUANI VEPRIMIN ME TË CILIN ËSHTË BËRË SHKELJA

---

---

---

---

9. PËRMENDNI CILAT MJETE JURIDIKE I KENI DORËZUAR (DERI TE CILI ORGAN DHE KUR)

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

10. SHTOJCA (DËSHMI):

---

---

---

---

11. NË ZYRËN E AVOKATIT TË POPULLIT JENI PRANUAR NGA (EMRI DHE MBIEMRI I NËPUNËSIT)

---

---

---

---

DATA

---

NËNSHKRIMI I PARASHTRUESIT